



2024

BULETINI

MARS



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin z. Diamant Bytyqi dhe drejtorin e Arsimit z. Rasim Hasani kanë marrë pjesë në hapjen e Kuizit të Diturisë

“Ne besojmë në fuqinë e edukimit dhe garës së diturisë për të ndihmuar në zhvillimin e të rinjve tanë, andaj ne do të vazhdojmë të mbështesim kuizet dhe iniciativat të tilla e të cilat inkurajojnë dijen dhe përgatitjen e brezit të ri , prandaj kudo që ka mundësi për të nxitur shkollimin dhe arsimimin e tyre, ne do të jemi aty për ti përkrahur”, ka thënë Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë kanë marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të pajisjeve të kamerave të sigurisë në fshatin Janjevë, projekt i realizuar në bashkëpunim me OSBE-në.

“Ky investim do të ndihmojë në monitorimin e aktivitetit në rrugë dhe hapësira publike, duke kontribuar në parandalimin e dukurive negative dhe rritjen e ndjenjës së sigurisë për banorët dhe vizitorët e Janjevës, siguria është prioritet për ne dhe kjo është një masë e rëndësishme për të garantuar që Janjeva të mbetet një vend i sigurt për të gjithë”, ka thënë Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me bashkëpunëtorët e tij, për nderë të 26 vjetorit të Epopesë së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në sheshin e qytetit.

Kryetari Imri Ahmeti, tha se çdo përvjetor i Epopesë së UÇK-së na bënë më përgjegjës ndaj detyrave që kemi dhe vetëm kështu nderojmë të rënët për lirinë që gëzojmë sot. Ai po ashtu ka thënë se se ditët e para të marsit do të mbeten të shënuara në historinë e Kombit shqiptarë, data këto të cilat ndër vite do reflektojnë qëndresën e Komandantit Adem Jashari dhe sakrificën e familjes së tij për liri dhe pavarësi.

Përlujë përjetësisht për heroizmin dhe sakrificën e Familjes Jashari! Lavdi!



Grupi i Grave në Lipjan, në kuadër të aktiviteteve të 8 marsit ditës ndërkombëtarë të gruas mbështetur nga Kryetari i Komunës dhe OSBE kanë organizuar Panair për Fuqizimin Ekonomik të Gruas në hollin e shpellës së Gadimes, aktiviteti ka për qellim avancimin e rolit të gruas në fushën e biznesit dhe njëherësh promovimin e produkteve të prodhuar nga vete grat.


“Panairi për Fuqizimin Ekonomik të Gruas është një nismë për të inkurajuar dhe për të ndihmuar gratë të zhvillojnë biznese të suksesshme, ne e shohim këtë panair si një platformë ku gratë mund të shfaqin kreativitetin e tyre, të promovojnë produktet e tyre dhe të ndërtojnë rrjetet e tyre në botën e biznesit, prandaj është tejet e rëndësishme fuqizimi ekonomik i grave pasi që vetëm në këtë mënyrë do të kontribuojmë në ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë”, është shprehur nënkryetari Bytyqi.



Mbahet mbledhja e parë e KKSB-së për vitin 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, në sallën e takimeve ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të parën për këtë vit, ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, në këtë takim ka propozuar që në të gjitha shkollat e Komunës së Lipjanit të mbahet një orë vetdijesuese kundër dukurive negative, ku me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e KKSB-së.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorë e tijë, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur lule pranë të rënëve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz në shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari z. Imri Ahmeti, tha se Këtë ditë të veçantë shprehim ri konfirmimin tonë për të vazhduar me përkushtim në forcimin e shtetësisë sonë, pa harruar asnjëherë kontributin e lavdisë të të gjitha gjeneratave për shtetin tonë, Kosovën tonë të dashur, duke përjetësuar lavdinë e atyre që kontribuan në luftën për liri.

Lavdi familjes Jashari

Lavdi komandantit Adem Jashari

Lavdi dëshmorëve të Kosovës



Komuna e Lipjanit ndan mirënjohje për mësime dhënësit e dalluar

Për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Drejtorati Komunal i Arsimit në Lipjan, ka organizuar ceremoninë e zgjedhjes së punëtorit të dalluar të vitit 2024, me ç ‘rast janë ndarë mirënjohje edhe për mësime dhënësit e dalluar në secilën shkollë.

Mësime dhënësi i dalluar për këtë vit në nivel komune është zgjedhur Mehmed Neziri nga Shfmu “Dy Dëshmorët” Dobrajë e Madhe.

Ndarja e mirënjohjeve është bërë nga Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan, z. Rasim Hasani dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunë, z. Daut Azemi të cilët njëkohësisht i ‘u kanë uruar festën dhe kanë vlerësuar lartë punën dhe kontributin e secilit në kuadër të shkollave respektive.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në zyrën e tij Mësuesin e Dalluar të vitit në nivel komunal, z. Mehmed Neziri, nga SH.F.M.U "Dy Dëshmorët" në Dobrajë të Madhe, duke e uruar atë dhe njëkohësisht ka falënderuar për angazhimin dhe ndikimin që ka pasur në edukimin e nxënësve.

Kryetari z. Ahmeti shtoi se mësuesi z. Mehmed Neziri është një model frymëzimi dhe shembull për të gjithë mësuesit e rinj, për punën dhe përkushtimin e tij në shërbim të arsimit.

Mësuesi z. Mehmed Neziri shprehu mirënjohjen e tij për këtë dhuratë dhe falënderoi Kryetarin Ahmeti për njohjen dhe nderimin e kontributit të tij. Ai premtoi se do të vazhdojë të punojë me të njëjtën përkushtim për të ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e arsimit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorë kanë vizituar familjen Mziu në fshatin Vërshevc, të cilës i është djegur shtëpia.

Kryetari Ahmeti ka shprehur keqardhje dhe njëkohësisht ka thënë se komuna do të marrë për obligim pagesën e qerasë për familjen Mziu dhe do të ndihmojmë në ndërtimin e shtëpisë së re.



Në sallën e takimeve u mbajt takimi i katërt i rregullt i Këshillit Publiko – Privat, i ftuar nga kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti në kuadër të bashkëpunimit me programin e USAID-it, Qeverisja e Pronës.

“Ky takim i sotëm së bashku me ju është thirrur për të diskutuar çështje të ndryshme pronësore dhe çështje tjera të bizneseve e që janë në interesin e përbashkët, është takimi i parë i këtij viti në fakt edhe vitin e kaluar kemi mbajtur disa takime dhe Ju falënderoj për kontributin tuaj që po jepni për shoqërinë tonë për afarizmin tuaj të mirë sepse besoj që suksesi juaj është në të mirë jo vetëm për punësim por edhe për gjenerimin e të ardhurave për çdo familje dhe normalisht për shtetin” është shprehur kryetari z. Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, me bashkëpunëtorët e tij, kanë pritur Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani - Sadriu.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka njoftuar Presidenten znj. Vjosa Osmani lidhur me arritjet dhe projektet që janë duke u zhvilluar në Komunën e Lipjanit.

“Presidenten Osmani e informova lidhur me arritjet e deritanishme si dhe për projektet që po realizohen në Komunën e Lipjanit, por njëkohësisht edhe për sfidat dhe çështje të tjera me të cilat ballafaqohemi si pushtet lokal”, është shprehur Kryetari Ahmeti.

Nga ana tjetër Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani – Sadriu, gjatë vizitës në Komunën e Lipjanit tha se nga puna e Kryetarit z. Imri Ahmeti, lipjanasit kanë me çka të krenohen.

“Ne sot me Lipjanin po i vazhdojmë vizitat nëpër komuna, Imri Ahmeti është një prej kryetarëve që njihemi më shumë se 20 vite. Nga puna e tij e deritanishme, qytetarët e Lipjanit jam e bindur që kanë me çka të krenohen”, ka thënë ndër të tjera Presidentja Osmani, duke shtuar se Lipjani është Komunë që ka ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për bizneset, janë mbi 2 mijë biznese që operojnë këtu.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti me bashkëpuntorët e tij, kanë bërë homazhe dhe ka vënë kurorë lulesh pranë pllakës përkujtimore të Heroit të Kombit, Ismet Asllani, me rastin e 25 vjetorit të rënies së tij.

“Idealet e Ismetit e të shokëve të tij për një shtet të prosperuar e zhvilluar janë detyrim dhe inspirim i përherëshëm i gjithë neve”, është shprehur kryetari Ahmeti. Lavdi Heroit Ismet Asllani – Prapashtica!



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me kolegët nga Asociacioni i Komunave të Kosovës po marrin pjesë në sesionin e 46-të të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

Në këtë takim me rëndësi për pushtetin lokal në Evropë, kryetari Ahmeti dhe delegacioni nga Kosova po marrin pjesë në seanca dhe punime të Kongresit duke përfaqësuar pushtetin lokal të Republikës së Kosovës në forumin e së ardhmes të demokracisë lokale dhe rajonale.



Kuvendi i Komunës së Lipjanit zhvilloi punimet e mbledhjes së 28-të

Kuvendi i Komunës së Lipjanit udhëhequr nga Kryesuesi, Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 28-të me radhë, në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat ishin të propozuara për këtë mbledhje.


Kryetari Imri Ahmet, fillimisht ka dhënë sqarime në të gjitha çështjet dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me Nënkryetarin z. Diamant Bytyqi si dhe drejtoreshën për Kultur Rini dhe Sport znj. Anila Reçica Llugini morën pjesë në maratonën “Vrapojmë shtigjeve të Haradin Bajramit”.

Ky aktivitet organizohet për nderim dhe kujtim të 25 vjetorit të rënies së heroit Haradin Bajrami, kjo është një mënyrë e veçantë për të nderuar kontributin e dhënë për çlirimin e vendit tonë.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë